



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.34/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër kandidatëve për deputet të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN TË PABAZUARA ankesat ZP.Anr.34/2026, ZP.Anr.35/2026, ZP.Anr.36/2026, ZP.Anr.37/2026, ZP.Anr.38/2026, ZP.Anr.43/2026, të datës 09.06.2026, parashtruar nga Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të parashtruara kundër kandidatëve për deputet të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Zoja Lohaj Konjufca, Adelina Thaçi Meta, Lulzim Zeneli, Blerim Kuçi, Kreshnik Çollaku dhe Oltion Ahmeti për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZP.Anr.34/2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se më datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në platformën zyrtare Meta Ad Library, është evidentuar reklamë politike aktive e sponsorizuar nga Zoja Lohaj Konjufca, kandidatë e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK. Si provë ka bashkëngjitur foto screenshot i bashkëngjitur nga Meta Ad Library. Nga prova shihet qartë se në momentin e verifikimit, në ora 14:35, në faqen e Meta Ad Library për "Zoja Lohaj Konjufca", reklama politike figuron me statusin "Active", përkatësisht si reklamë ende aktive dhe në qarkullim publik në platformat e Meta-s. Reklama e evidentuar përmban elemente të

qarta zgjedhore dhe promovuese. Ajo është e sponsorizuar, paraqitet nga faqja e kandidatës Zoja Lohaj Konjufca, dhe përmban mesazh politik lidhur me çështje lokale dhe angazhim elektoral. Për më tepër, reklama shfaqet në Meta Ad Library me status aktiv në ditën e votimit, çka nënkupton se ajo ka qenë ende duke u shpërndarë te përdoruesit gjatë kohës kur votuesit kanë qenë duke ushtruar të drejtën e votës. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Rrjedhimisht, kërkojmë nga PZAP që ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik përgjegjës.

Me datën 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZP.Anr.35/2026, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datën 07.06.2026 në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në platformën Meta Ad Library janë evidentuar reklama politike aktive të sponsorizuara nga Adelina Thaçi Meta, kandidatë për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se nga provat shihet qartë se në momentin e verifikimit, në ora 12:53, në faqen e Meta Ad Library për Adelina Thaçi Meta, reklamën politike figurojnë më statusin "Active" përkatësisht si reklama ende aktive dhe në qarkullimin publik në platformat e Meta-s. Parashtruesi i ankesës shton se reklamën e evidentuarë përmbajnë elemente të qarta zgjedhore dhe promovuese: emrin e kandidatës, numrin e saj në listë 18, logon dhe numrin e subjektit politik LDK 113 si dhe mesazhe politike si "VOTO 18" dhe "BASHKOHU" pra nuk behet fjalë për përmbajtje neutrale apo informim publik por për material të sponsorizuar politik, të paguar dhe të shpërndarë me qëllim të ndikimit të votuesit, veprim që është në kundërshtim më nenin 8, par.1 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik.

Me datën 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.36/2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se më datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në platformën zyrtare Meta Ad Library, janë evidentuar reklama politike aktive të sponsorizuara nga Lulzim Zeneli, kandidat i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK. Nga prova shihet qartë se në momentin e verifikimit, në ora 13:22, në faqen e Meta Ad Library për "Lulzim Zeneli", reklamën politike figurojnë me statusin "Active", përkatësisht si reklama ende aktive dhe në qarkullim publik në platformat e Meta-s. Reklamën e evidentuarë përmbajnë elemente të qarta zgjedhore dhe promovuese: emrin e kandidatit, numrin e tij në listë 44, logon dhe numrin e subjektit politik LDK 113, si dhe mesazhe politike si "VOTO 50" Pra, nuk bëhet fjalë për përmbajtje neutrale apo informim publik, por për material të sponsorizuar politik, të paguar dhe të shpërndarë me qëllim të ndikimit tek votuesit. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Rrjedhimisht, kërkojmë nga PZAP që ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik përgjegjës. Si prove ka bashkangjitur screenshot të fotografisë.

Me datën 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.37/2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se më datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në platformën zyrtare Meta Ad Library, janë evidentuar reklama politike aktive të sponsorizuara nga Blerim Kuçi, kandidat i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK. Si provë ka bashkangjitur foto screenshot nga Meta Ad Library. Nga prova shihet qartë se në momentin e verifikimit, në ora 13:15, në faqen e Meta Ad Library për "Blerim Kuçi", reklamën politike figurojnë me statusin "Active", përkatësisht si reklama ende aktive dhe në qarkullim publik në platformat e Meta-s. Reklamën e evidentuarë përmbajnë elemente të qarta zgjedhore dhe promovuese: emrin e kandidatit, numrin e tij në listë 44, logon dhe numrin e subjektit politik LDK 113, si dhe mesazhe politike si "VOTO 33". Pra, nuk bëhet fjalë për përmbajtje neutrale apo informim publik, por për material të sponsorizuar politik, të paguar dhe të shpërndarë me qëllim të ndikimit tek votuesit. Duke qenë se një veprim I tillë është në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, kërkojmë nga PZAP që ta aprovojë si të bazuar këtë ankesë dhe të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik përgjegjës.

Me datë 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.38/2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në platformën zyrtare Meta Ad Library, janë evidentuar reklama politike aktive të sponsorizuara nga Kreshnik Çollaku, kandidat i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK. Parashtruesi i ankesës thekson se nga prova shihet qartë se në momentin e verifikimit, në ora 13:00, në faqen e Meta Ad Library për "Kreshnik Çollakun Meta", reklamën politike figurojnë me statusin "Active", përkatësisht si reklama ende aktive dhe në qarkullim publik në platformat e Meta-s, dhe reklamën e evidentuarë përmbajnë elemente të qarta zgjedhore dhe promovuese: emrin e kandidatit, numrin e saj në listë 33, logon dhe numrin e subjektit politik LDK 113, si dhe mesazhe politike si "VOTO 33". Parashtruesi i ankesës thekson se nuk bëhet fjalë për përmbajtje neutrale apo informim publik, por për material të sponsorizuar politik, të paguar dhe të shpërndarë me qëllim të ndikimit tek votuesit. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 8, par.1 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik. Si dëshmi ka bashkangjitur screenshot i bashkëngjitur nga Meta Ad Library.

Me datën 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.43/2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se më datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në platformën zyrtare Meta Ad Library, është evidentuar reklamë politike aktive e sponsorizuar nga Oltion Ahmeti, kandidat i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK. Si provë ka bashkangjitur foto screenshot i bashkëngjitur nga Meta Ad Library. Nga prova shihet qartë se në momentin e verifikimit, në ora 14:33, në faqen e Meta Ad Library për "Oltion Ahmeti", reklama politike figuron me statusin "Active", përkatësisht si reklamë ende aktive dhe në qarkullim publik në platformat e Meta-s. Reklama e evidentuarë përmban elemente të drejtpërdrejta zgjedhore dhe

promovuese: emrin e kandidatit Oltion Ahmeti, numrin e tij në listë 96, logon dhe numrin e subjektit politik LDK 113, si dhe thirrje të qartë politike për votim, përmes përmbajtjes "Oltion Ahmeti 96" dhe #LDK113". Përmbajtja nuk është informim neutral, por material i sponsorizuar politik, i paguar dhe i shpërndarë me qëllim të ndikimit tek votuesit. Sipas nenit 8, paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohet shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi. Prandaj, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që ta aprovojë si të bazuar këtë ankesë dhe të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik përgjegjës.

Në përgjigje në ankesat ZP.Anr.34/2026, ZP.Anr.35/2026, ZP.Anr.36/2026, dhe ZP.Anr.43/2026 subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka deklaruar se kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në ankesat e subjektit LVV dhe te njëjtat janë të pabazuara në fakte dhe në të drejtën e aplikueshme. Së pari, ankesat nuk arrijnë të provojnë se reklammat politike ne platformen facebook te kandidateve për deputete Adelina Thaqi Meta, Zoje Lohaj Konjufca, Lulzim Zeneli dhe Oltion Ahmeti kane qëndruar te sponsorizuara edhe pas ores 06:59 te datës 07.06.2026. Kandidatët në fjale kanë paraqit provat e mjaftueshme me te cilat hedhin këto pretendime te pabazuara dhe te cilat madje përbëjnë edhe abuzim me te drejtën e ankesës nga ana e ankuesit. Bashkëngjitur gjeni provat dhe sqarimet e kandidateve ne fjale. Për më tepër, ky pretendim është krejtësisht i paqëndrueshëm, ngase nuk është i evidentuar ne ndonjë CD-Video, ku tregohet e gjithë rrjedha e pretendimit ankimor te tyre, por thjesht ne një faqe me mbishkrimin active, i cili mund te editohet lehte me Inteligjencë Artificiale dhe te tentohet dëmtimi i palës tjetër. Pra, prova nuk është direkte, e vërtete dhe e plote, pra si e tille është e rrezikshme dhe nuk përmban as element indikativ për gjobëvënie, por as nuk përbën fare shkelje te Ligjit Zgjedhor apo rregulloreve perkatese zgjedhore. Për shembull ta zëmë, ka plot raste qe PZAP ka vendosur me refuzim pretendimet e tilla apo edhe për rastet e fotove te profileve apo prapavijës ne rrjetin social facebook apo instagram, te cilat nuk i kane ndërruar fare te gjithë kandidatet e te gjitha partive politike pa përjashtim, qe nga shpallja e zgjedhjeve e edhe gjate heshtjes zgjedhore, pra nëse behet krahasimi për ndonjë pretendim shkelës ky është me i duhuri. Nëse për fotot e profileve dhe prapavijes ne keto rrjete sociale te cilat kane qëndruar te vendosura edhe ne ditën e zgjedhjeve, njëjtë do duhej te konsideroheshin edhe rastet e ankimuara, aq me tepër qe për këto raste ka prova qe dëshmojnë te kundërtën e pretendimit ankimor. Për këto arsye, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që ankesat e LVV të refuzojë si të pabazuara.

PZAP me datë 09.06.2026 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë ZP.Anr.37/2026 tek subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), mirëpo i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë ZP.Anr.38/2026 të subjekti politik LDK sqarojnë se provat që paraqiten me këtë kundërshtim tregojnë një gjendje tjetër faktike: faqja e përdorur për veprimtarinë zgjedhore në Kosovë nuk ka pasur reklamë të sponsorizuar gjatë periudhës së pretenduar, ndërsa reklama e evidentuar në ankesë lidhet me një prani tjetër elektronike dhe

me një konfigurim reklamues të autorizuar për Shqipërinë. Në faqen me emërtimin "Kreshnik Çollaku Ldk", e përdorur për paraqitjen zgjedhore në Kosovë, i vetmi veprim i evidentuar ka qenë përditësimi i fotografisë së profilit. Ky veprim nuk përbën krijim reklame; nuk përbën sponsorizim; nuk përbën "boost" të një publikimi, nuk përbën aktivizim të një fushate me pagesë; nuk provon shpërndarje të sponsorizuar; nuk përputhet me faktin specifik të pretenduar në ankesë. Objekti i ankesës është ekzistenca e pretenduar e reklamave politike aktive dhe të sponsorizuara gjatë ditës së votimit. Përditësimi i fotografisë së profilit është veprim teknik dhe organik i administrimit të faqes, juridikisht i ndryshëm nga porositja dhe shpërndarja e një reklame të paguar. Duke qenë se ankuesi nuk ka provuar ekzistencën e një reklame të sponsorizuar aktive në faqen "Kreshnik Çollaku LDK" gjatë ditës së votimit, dhe nuk është paraqitur provë për targetim, shpërndarje, shfaqje ose shpenzim reklamues në Republikën e Kosovës, kërkojmë nga PZAP që të refuzojë ankesën e LVV si të pabazuar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafit 5.5 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.34/2026, ZP.Anr.35/2026, ZP.Anr.36/2026, ZP.Anr.37/2026, ZP.Anr.38/2026 dhe ZP.Anr.43/2026, të datës 09.06.2026 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZP.Anr.34/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjeve në ankesë, vëren se:

- **Ankesat janë të pabazuar.**

Parashtruesi i ankesës subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në ankesat e saj ka pretenduar se kandidatët për deputet të subjektit politik (LDK) në ditën e votimit, gjatë heshtjes zgjedhore, kanë pasur reklamën politike aktive në platformën facebook të kandidatëve për deputetë, Zoje Lohaj Konjufca, Adelina Thaqi Meta, Lulzim Zeneli, Blerim Kaçi, Kreshnik Çollaku dhe Oltion Ahmeti dhe të njëjtat kanë qëndruar të sponsorizuara edhe pas orës 06:59 të datës 07.06.2026. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 37 par. 1 pika 2 i Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet E Përgjithshme Në Republikën E Kosovës "1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndaloheq secili prej veprimeve si më poshtë: ...1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre", apo nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafin 1.5, të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 "1. Nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen veprimet më poshtë: ... 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi..."

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi të bashkangjitura si dëshmi nuk shihet ndokund data 07 Qershor 2026 për të cilën pretendohet si datë e publikimit të fotove -

postimeve në rrjetin social Facebook të kandidatëve për deputete e subjektit politik LDK, meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të të njëjtëve. Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, me të cilin parasheh *”Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme”*. Andaj Paneli ndërmoi hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se postimet në fjalë për të cilin pretendohet në ankesë nuk janë publikuar në ditën e fushatës. Andaj bazuar në ato që u tha Paneli nuk ka gjetur shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Paneli, vlerësoi se ankesat janë të pabazuar, pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtruesi i ankesave i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se janë kryer shkeljet e pretenduara për të cilën referohet pala ankuese, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se postimet janë bërë gjatë fushatës zgjedhore, që do të thotë para fillimit të heshtjes zgjedhore, ndërsa pas hetimit të bërë nga ana e panelit nuk ka mundur të vërtetohet se e njëjta reklamë është postuar apo është ri postuar në ditën e zgjedhjeve apo se është bërë fushatë në ndonjë mënyrë tjetër në ditën e zgjedhjeve, siç pretendohet në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.34/2026 më datën 11.06.2026

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.